

## Mbetjet bio

Në kontenierët ngjyrë kafe për mbeturinat bio, klasifikohen të gjitha mbeturinat organike, si frutat, perimet, mbetjet e kopshtit, filtrat e kafesë, filtrat e çajit, mbetjet e bukës, paketimet e vezëve, etj.

**Kujdes:** Të gjitha mbeturinat e tjera nuk ka arsye të hidhen në kontenierët bio dhe janë të rrëzikshme gjatë procesit të dekompozimit! Edhe qeset e mbeturinave bio me material të dekompozueshëm, pavarësisht nëse etiketohen si të tilla ose jo, nuk lejohet të hidhen në kontenierët bio.

**Këshillë:** Për të mos lejuar mbledhjen e larvave, të gjitha mbetjet bio duhet të mblidhen menjëherë me një fletë gazete dhe të hidhen më pas në kontenierët bio. Një tjetër alternativë janë edhe qeset e vogla prej letre për mbeturinat bio, që mund të blihen në dyqane.